



Mësimi i teuhidit fëmijëve

në formë të pyetjeve & përgjigjeve

MUHAMMED IBN ABDULVEHABI

Mësimi i Teuhidit fëmijëve

Imam Muhammed bin Abdil-Vehab (v. 1206) (Allahu e mëshiroftë!)

Përgatiti:



أعوذ بالله من الشيطان الرجيم

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Hamdi dhe lavdërimi i takon Allahut, Zotit të krijesave. Paqja dhe salavatet e Allahut qofshin mbi prijësin e të dërguarëve, pasardhësit e tij dhe të gjithë shokët e tij.

Më tutje:

Kjo është një broshurë e dobishme rreth asaj që njeriu duhet t'u mësojë fëmijëve para se t'u mësojë Kuranin, me qëllim që ata të bëhen muslimanë të plotë në besimin Islam dhe ta adhurojnë vetëm Allahun sipas rrugës së besimit. Librin e kamë radhitur në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Pyetja nr 1: Nëse pyetesh: Kush është Zoti yt?

Përgjigje: Përgjigju: Zoti im është Allahu.

Pyetja nr 2: Çfarë do të thotë **"Zot"**?

Përgjigje: Thuaj: Do të thotë: Sunduesi, Poseduesi, i Adhuruari, Ndihmuesi. **"Allah"** do të thotë: Ai që duhet të adhurohet nga të gjithë krijesat e Tij.

Pyetja nr 3: Si e njeh Zotin tënd?

Përgjigje: Unë e njohë Atë përmes argumenteve dhe krijesave të Tij. Disa prej argumenteve të Tij janë dita dhe nata, dielli dhe hëna. Disa nga krijesat e tij janë qiejt, toka dhe gjithçka që ato mbajnë dhe përmbajnë. Dëshmi për këtë janë fjalët e Allahu (Te ala):

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ اسْتَوَىٰ عَلَى الْعَرْشِ
يُعْشِي اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ أَلَا لَهُ
الْخَلْقُ وَالْأَمْرُ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ

“Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin, Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon atë (mbulimin e dritës së ditës), edhe dielli, edhe hëna e edhe yjet i janë nënshtruar sundimit të Tij. Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar është Allahu, Zoti i botëve!”¹

¹ 7:54

Pyetja nr 4: Pse të krijoi Ai?

Përgjigje: Për ta adhuruar vetëm Atë, i Cili nuk ka ortak, për t'iu nënshtruar Atij në urdhërat dhe ndalesat e Tij. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë."²

Allahu (Te ala) gjithashtu ka thënë:

وَاعْبُدُوا اللَّهَ وَلَا تُشْرِكُوا بِهِ شَيْئًا

"Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send."³

Idhujtaria është mëkati më i madh me të cilin është kundërshtuar Allahu. Allahu (Te ala) ka thënë:

إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ

"Se, me të vërtetë, kush i bën shok Allahut, Allahu ia ka ndaluar atij Xhenetin dhe vendi i tij është zjarri."⁴

Idhujtaria (shirku) është që të adhurosh dikë karshi Allahut, t'i lutesh atij, ta adhurosh atë, të shpresoshë në të, ti frikësohesh atij, ti mbështetesh atij, apo të përmallohesh për të karshi Allahut.

² 51:56

³ 4:36

⁴ 5:72

Adhurimi për fëmijë

“Adhurim” është një emër përmbledhës për çdo gjë që e do Allahu, fjalët dhe veprimet e dukshme dhe të padukshme. Pjesë e adhurimit është edhe lutja. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

“Dhe (mua më shpallet) se vërtet xhamitë janë veçant për ta adhuruar Allahun, e mos e lutni në to askë tjetër me Allahun!”⁵

Dëshmi se është mosbesim që ti lutesh dikujt tjetër pos Allahut janë fjalët e Tij (Te ala):

وَمَنْ يَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا بُرْهَانَ لَهُ بِهِ فَإِنَّمَا حِسَابُهُ عِنْدَ رَبِّهِ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ
الْكَافِرُونَ

“E kush lut me Allahun edhe ndonjë zot tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, përgjegjësia e tij është para Zotit të vet, e mohuesit nuk do të shpëtojnë!”⁶

Kjo është për shkak se lutja është një nga format kryesore të adhurimit. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ إِنَّ الَّذِينَ يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِي سَيَدْخُلُونَ جَهَنَّمَ
دَاخِرِينَ

“Zoti juaj ka thënë: “Më lutni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në Xhehenem.”⁷

⁵ 72:18
⁶ 23:117
⁷ 40:60

Në librat e Sunneneve transmetohet nga Enesi se profeti (salAllahu alejhi ue selem) ka thënë: **"Lutja është palca e adhurimit."**⁸

⁸ Tirmidhi (3371). I dobët sipas Imam Albanit në "Daif-ul-Xhemi" (3003).

Detyrimi i parë për fëmijët

Gjëja e parë që Allahu i ka detyruar robërit e Tij ishte që të mohojnë tagutin dhe të besojnë në Allahun. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: “Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni tagutit!”⁹

Tagut është:

1. Çdo gjë që adhurohet në vend të Allahut.
2. Shejtani.
3. Parashikuesi.
4. Astrologi.
5. Ai që gjykon me ndonjë gjë tjetër përveç ligjit të Allahut.
6. Çdo gjë që pasohet dhe bindet në diçka që nuk është e vërtetë.

Alameh Ibn-ul-Kajimi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë:

“Tagut është tërë ajo që robi i tejkalon kufijtë e tij, qoftë në adhurim, në pasim apo në nënshtrim.”¹⁰

⁹ 16:36

¹⁰ (I’lam-ul-Muvakki’in (1/5)).

Islami për fëmijë

Pyetja nr 5: Cila është feja jote?

Përgjigje: Feja ime është Islami. Islam do të thotë që t'i nënshtrohesh Allahut duke i besuar vetëm Atij, ti nënshtrohet Atij duke iu bindur me ibadet vetëm Atij, ti duash muslimanët dhe t'i urresh idhujtarët.

Allahu (Te ala) ka thënë:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ

"Feja e pranueshme tek Allahu është Islami."¹¹

Allahu (Te ala) ka thënë gjithashtu:

وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit."¹²

Është transmetuar në mënyrë autentike se profeti (salAllahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Islami është që të dëshmosh se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut, dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe ta kryesh haxhin në shtëpinë (e shenjtë) nëse ke mundësi ta bëshë atë."¹³

¹¹ 3:19

¹² 3:85

¹³ Bukhari (4777) dhe Muslim (102).

Pesë shtyllat e Islamit

Shahadeti **“La ilahe ila Allah”** do të thotë se nuk lejohet të adhurohet askush tjetër me të drejtë përveç Allahut. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ إِنَّنِي بَرَاءٌ مِّمَّا تَعْبُدُونَ إِلَّا الَّذِي فَطَرَنِي فَإِنَّهُ سَيَهْدِينِ
وَجَعَلَهَا كَلِمَةً بَاقِيَةً فِي عَقِبِهِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ

(Kujtoje ti o Muhammed!) kur Ibrahim i tha të atit dhe popullit të tij: “Unë jam larg atyre që i adhuroni ju, pos Atij, që më ka krijuar (mua) – dhe, me të vërtetë, Ai më udhëzon në rrugën e drejtë.”¹⁴

Dëshmia se duhet ta falim namazin dhe ta paguajmë zekatin janë fjalët e Allahut (Te ala):

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ
وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ajo është feja e drejtë.”¹⁵

Gjëja e parë që Allahu e thotë në ajet është se duhet adhuruar vetëm Atë dhe se duhet qëndruar larg nga idhujtaria. Gjëja kryesore që Allahu ka urdhëruar është që vetëm Ai të adhurohet dhe gjëja më e keqe që Ai ka ndaluar është që dikush tjetër pos Tij të adhurohet. Allahu ka urdhëruar që të falemi dhe të paguajmë zekatin. Kjo është gjëja më madhështore në fe, ndërsa të gjitha dispozitat e tjera janë në pasim të saj.

¹⁴ 43:26-28

¹⁵ 98:5

Dëshmia se duhet agjëruar janë fjalët e Allahut (Te ala):

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ
أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ فَمَن كَانَ مِنكُم مَّرِيضًا أَوْ عَلَى سَفَرٍ فَعِدَّةٌ مِّنْ أَيَّامٍ أُخَرَ وَعَلَى الَّذِينَ
يُطِيقُونَهُ فِدْيَةٌ طَعَامُ مِسْكِينٍ فَمَن تَطَوَّعَ خَيْرًا فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ وَأَن تَصُومُوا خَيْرٌ لَّكُمْ إِن
كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ الْهُدَى
وَالْفُرْقَانِ فَمَن شَهِدَ مِنكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.

Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të. Por, agjërimi juaj është më i dobishëm, në qoftë se e dini. Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar.”¹⁶

Dëshmia se duhet të kryejmë haxhin janë fjalët e Allahut (Te ala):

وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا

“Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo.”¹⁷

¹⁶ 2:183-185

¹⁷ 3:97

Besimi në Gjashtë shtyllat e besimit

Besimi ka gjashtë shtylla. Ato janë që të besosh në:

1. Allahun.
2. Engjëjt e Tij.
3. Librat e Tij.
4. Të dërguarit e Tij.
5. Ditën e fundit.
6. Të mirën dhe të keqën në kader.

Dëshmia për këtë është hadithi i vërtetë i transmetuar nga Umer bin el-Hatab (radijAllahu anhu):

“Një ditë, kur ne ishim ulur me të dërguarin e Allahut (salAllahu alejhi ue selem), një njeri erdhi tek ne me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zinjë. Tek ai nuk dukeshin shenjat e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njihte atë. Ai u ul pranë profetit (salAllahu alejhi ue selem) dhe i mbështeti gjunjët e tij me gjunjët e profetit dhe i vendosi duart e tij mbi kofshët e tij. Ai tha: “O Muhammed, më informo mua rreth Islamit!” I dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selem) tha: “Islami është të dëshmosh se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush përveç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjëroshë Ramazanin dhe të bësh haxhin në shtëpinë e shenjtë nëse ke mundësi.” Ai tha: “Ke thënë të vërtetën.” Ne u befasuam sepse ai e pyeste atë dhe pastaj ia konfirmonte se ai e kishte thënë të vërtetën. Pastaj ai tha: “Më informo rreth Imanit!” Ai tha: “Imani është që të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit, dhe të besosh në kaderin, se e mira dhe e keqja vijnë prej Allahut.” Ai tha: “Ke thënë të vërtetën.” “Ai tha: më informo rreth Ihsanit!” Ai u përgjigj: “Ta adhurosh Allahun sikurse po e sheh Atë. Se edhe pse ti nuk e sheh Atë, vërtet Ai të sheh ty.” Ai tha: “Më njofto rreth Çastit.” Ai tha: “I pyeturi nuk di më shumë se pyetësi.” Ai tha: “Më lajmëro për shenjat e tij!” Ai tha: “Robëresha do të lind zonjën e saj, dhe do ti shihni barinj të këmbëzbathur, të zhveshur dhe të varfër se si do të garojnë në ndërtimin e ndërtesave të larta.”

Pastaj ai shkoi dhe unë mbeta ulur për një kohë të gjatë. Pastaj ai (salAllahu alejhi ue selem) tha: "O Umer, a e di se kush qe pyetësi?" Unë u përgjigja: "Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri." Ai tha: "Ai ishte Xhibrili që erdhi tek ju për t'jua mësuar fenë tuaj."¹⁸

¹⁸ (Muslimi)

Besimi në profetin Muhammed

Pyetja nr 6: Kush është profeti yt?

Përgjigje: Profeti ynë është Muhammed bin Abdil-lah bin Abdil-Muttalib bin Hashim bin Abdi Menaf.

Allahu (Te ala) e zgjodhi atë prej fisit Kurejsh. Ishte më i zgjedhuri nga pasardhësit e Ismailit (alejhi-selam). Allahu dërgoi Muhammedin (salAllahu alejhi ue selem) tek njerëzit e bardhë dhe tek zezakët. Allahu ia shpalli librin dhe urtësinë atij. Muhammedi (salAllahu alejhi ue selem) i thirri njerëzit që të adhurojnë vetëm Allahun dhe të ndalen nga adhurimi i çdo gjëje tjetër nga statujat, gurët, pemët, profetët, njerëzit e drejtë, engjëjt dhe të tjera.

Muhammedi (salAllahu alejhi ue selem) i thirri njerëzit që të braktisin idhujtarinë. Ai luftoi kundër tyre, në mënyrë që ata të braktisin idhujtarinë dhe në vend të kësaj të adhurojnë vetëm Allahun. Allahu (Te ala) ka thënë:

قُلْ إِنَّمَا أَدْعُو رَبِّي وَلَا أُشْرِكُ بِهِ أَحَدًا

Thuaj (o Muhammed!): "Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe askë s'ia bëjë shok Atij."¹⁹

قُلِ اللَّهُ أَعْبُدُ مُخْلِصًا لَهُ دِينِي

"Thuaj: "Vetëm Allahun e adhuroj sinqerisht me besimin tim të plotë."²⁰

¹⁹ 72:20
²⁰ 39:14

قُلْ إِنَّمَا أُمِرْتُ أَنْ أَعْبُدَ اللَّهَ وَلَا أُشْرِكَ بِهِ إِلَيْهِ أَدْعُو وَإِلَيْهِ مَآبِ

"Thuaj: "Mua më është urdhëruar që ta adhuroj vetëm Allahun dhe që mos t'i bëj shok Atij. Vetëm Atij i lutëm dhe vetëm tek Ai kthehem."²¹

قُلْ أَفَعَيَّرَ اللَّهُ تَأْمُرُونِي أَعْبُدُ أَيُّهَا الْجَاهِلُونَ وَلَقَدْ أُوحِيَ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِكَ لَئِنْ أَشْرَكْتَ لَيَحْبَطَنَّ عَمَلُكَ وَلَتَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ بَلِ اللَّهُ فَاعْبُدْ وَكُنْ مِنَ الشَّاكِرِينَ

Thuaju atyre: "Vallë, a ju po më urdhëroni që të adhuroj dikë tjetër, përveç Zotit, o injorantë. Me të vërtetë, të është shpallur ty edhe atyre (profetëve) që kanë qenë para teje: "Nëse i përshkruan Allahut shok, me siguri do të të humbin punët tuaja dhe do të jesh ndër ata që janë shkatërruar. (Mos adhuro idhujt), por adhuro vetëm Allahut dhe bëhu falenderues!"²²

²¹ 13:36

²² 39:64-66

Besimi në Ringjalljen

Prej bazave të besimit që të ruajnë nga mosbesimi është që të besosh në:

1. Ringjalljen.
2. Dhënien llogari.
3. Gjykimin.
4. Xhenetin.
5. Xhehnemin. Të besosh se të gjitha këto janë të vërteta.

Allahu (Te ala) ka thënë:

مِنْهَا خَلَقْنَاكُمْ وَفِيهَا نُعِيدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً أُخْرَى

“Na ju kemi krijuar juve prej saj (tokës), dhe në të do t’ju kthejmë, dhe nga ajo do t’ju nxjerrim juve herën tjetër.”²³

Allahu (Te ala) gjithashtu ka thënë:

وَإِنْ تَعْجَبْ فَعَجَبٌ قَوْلُهُمْ أَإِذَا كُنَّا تُرَابًا أَيْنَا لَفِي خَلْقٍ جَدِيدٍ أُولَئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا
بِرَبِّهِمْ وَأُولَئِكَ الْأَغْلَالُ فِي أَعْنَاقِهِمْ وَأُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ

“ E, nëse çuditesh, pra – çudi janë fjalët e tyre: “A vallë, me të vërtetë pasi të bëhemi tokë, do të krijohemi përsëri?” Ata, nuk besojnë në Zotin e tyre, këta janë ata, në qafat e të cilëve do të ketë pranga; këta janë banorët e Xhehenemit, në të cilin do të qëndrojnë përgjithmonë.”²⁴

²³ 20:55

²⁴ 13:5

Ajeti dëshmon se kushdo që e mohon Ringjalljen ka rënë në mosbesim për shkak të të cilit do të përfundojë në zjarrin e përjetshëm. Allahu na mbrojtë nga mosbesimi dhe veprimet e mosbesimit.

Thirrja e profetit

Këto ajete të Kuranit dëshmojnë se i dërguari (salAllahu alejhi ue selem) u dërgua që ti urdhëroj njerëzit që ta adhurojnë vetëm Allahun dhe që ti ndalojë ata që të adhurojnë dikë tjetër pos Allahut. Kjo është feja e tij (salAllahu alejhi ue selem) në të cilën i thirri njerëzit dhe për të cilën i luftoi. Allahu (Te ala) ka thënë:

وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّى لَا تَكُونَ فِئْتَةٌ وَيَكُونَ الدِّينُ كُلُّهُ لِلَّهِ

“Luftoni ata derisa të mos mbetet idhujtari (besimi i kotë), e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun.”²⁵

Sprova është idhujtaria.

Allahu (Te ala) dërgoi Muhammedin (salAllahu alejhi ue selem) kur ai ishte dyzet vjet. Për dhjetë vite ai i thirri njerëzit që të adhurojnë vetëm Allahun dhe të mos adhurojnë askë tjetër pos Allahut. Pastaj Allahu e ngriti lart në një udhëtim për në qiell. Lartë në qiell, ai u detyrua të falet pesë herë në ditë, kur Allahu (Te ala) e urdhëroi atë (salAllahu alejhi ue selem) nuk kishte asnjë ndërmjetës mes tij dhe Allahut.

Pas kësaj, ai u urdhërua që të emigroi. Ai emigroi në Medine, ku u urdhërua gjithashtu të delë në xhihad. Për gati dhjetë vite ai bëri xhihad për hir të Allahut derisa njerëzit u konvertuan në Islam në grupe të mëdha.

Kur profeti (salAllahu alejhi ue selem) kishte mbushur gjashtëdhjetë e tre vjet dhe Allahu (Te ala) kishte përbushur fenë nëpërmjet tij dhe lejoi që ai të kumtoi shpalljen e Allahut, ai vdiq. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të.

²⁵ 8:39

Besimi në profetët

I dërguari i parë ishte Nuhi (alejhi-selam). I dërguari i fundit ishte Muhammedi (salAllahu alejhi ue selem).

Allahu (Te ala) ka thënë:

إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ

"Ne të frymëzuar ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe profetët pas tij."²⁶

Allahu (Te ala) gjithashtu ka thënë:

وَمَا مُحَمَّدٌ إِلَّا رَسُولٌ

"Muhammedi nuk është tjetër vetëmse profet."²⁷

Allahu (Te ala) ka thënë:

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا

"Muhammedi nuk është babë i askujt prej njerëzve (meshkujve) tuaj, por është i dërguari i Allahut dhe vula e profetëve, e Allahu është i Gjithëdijsëm për çdo gjë."²⁸

²⁶ 4:163

²⁷ 3:144

²⁸ 33:40

I dërguari më i mirë është profeti ynë Muhammedi (salAllahu alejhi ue selem). Njerëzit më të mirë pas profetëve janë Ebu Bekri (radijAllahu anhu), pastaj Umeri (radijAllahu anhu), pastaj Uthmani (radijAllahu anhu) dhe pastaj Aliu (radijAllahu anhu). Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata. Profeti (salAllahu alejhi ue selem)ka thënë:

“Brezi më i mirë është brezi im, pastaj ai që vijen pas tij dhe pastaj ai që vjen pas tij.”²⁹

Përveç kësaj, Isai (salAllahu alejhi ue selem) do të zbretë poshtë nga qielli dhe do ta vret Dexhallin.³⁰

Hamdi dhe lavdërimi i takon Allahut.

Fund.

²⁹ Bukhari (2652) dhe Muslimi (6635)

³⁰ Muslimi (7560).